



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 17.07.2023)*

**Pika 2 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 287, datë 06.07.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).<sup>1</sup>

***Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:27 dhe mbaroi në orën 13.18.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                           |                          |
|---------------------------|--------------------------|
| <b>1. Ilir Rusi</b>       | <b>(zëvendëskryetar)</b> |
| <b>2. Klodian Kurushi</b> | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>3. Fatmira Luli</b>    | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>4. Dritan Hallunaj</b> | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>5. Ridvan Hado</b>     | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>6. Alban Toro</b>      | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>7. Marçela Shehu</b>   | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>8. Brikena Ukperaj</b> | <b>(anëtare)</b>         |

<sup>1</sup> Kjo pikë ishte parashikuar të trajtohej e para sipas rendit të ditës.

*Shënim:* Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor *znj. Irena Plaku*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Luan Dibra, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese e MD-së.*
5. *Valbona Bala, Eksperte (EWMI).*
6. *Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*
7. *Edmond Hoxhaj, BIRN.*

#### **RENDI I DITËS:**

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 287, datë 06.07.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

*Ilir Rusi:* Përshëndetje të nderuar!

Jave të mbarë!

Për shkak të një angazhimi institucional të Kryetares, mbledhja do të drejtohet nga ana ime, si Zëvendëskryetar, Ilir Rusi.

Sipas rendit të ditës, po vijojmë me diskutimet përkatëse.

Ka diskutim mbi rendin e ditës?

Po, zoti Kurushi!

***Klodian Kurushi:*** Faleminderit zoti Rusi!

Përshëndetje kolegë!

Përpara se sa të fillojmë shqyrtimin sipas rendit të ditës të të gjitha çështjeve që janë paraqitur sot në mbledhje për t'u diskutuar, paraprakisht do doja të bëja me dije Këshillin për disa çështje të cilat po i parashtroj më poshtë.

Fillimisht, referuar pikës 3 të rendit të ditës që ka për objekt shqyrtimin e projektvendimit “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 12 dhe nr. 13”, unë duke dashur të marrë edhe dakordësinë e Këshillit, do doja të deklaroja se e tërheqim fillimisht si projektvendim dhe relacionin përkatës, për shkak se ekzistojnë disa rrethana në momentin e fundit, pasi u konsultuam, disa rrethana të cilat çojmë se duhet të jenë pjesë e pasqyrimin në relacionin përkatës, gjë që nuk është bërë dhe unë e çmoj të nevojshme që t'i pasqyrojmë këto rrethana në relacionin përkatës. Kjo është arsyeja pse duam ta tërheqim dhe për të qenë më transparent, më të qetë dhe të paanshëm në relacionin që ne duhet të paraqesim. Tërheqim shqyrtimin e projektvendimit të pikës 3 në këtë seancë, për ta risjellë në mbledhjen e ardhshme. Kjo është e para.

Shqetësimi i dytë që kemi i referohet pikës 7 të rendit të ditës që bën fjalë për shqyrtimin e projektvendimit “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, të shpallur me vendimin nr. 15”. Meqenëse ka filluar verifikimi i kritereve ligjore të kandidimit në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për pozicionin e shpallur me vendimin nr. 14 dhe në pozicionin e shpallur nr. 14 dhe në atë nr. 15 ekziston një kandidate që është zonja {...}, ne në këtë rast propozojmë që të mos marrim në shqyrtim dhe të fillojmë procedurën dhe të përzgjedhim relatorin, ashtu siç e kemi propozuar në pikën 7, por këtë relacion t'ia bashkojmë procedurës së nisur tashmë për verifikimin e kritereve ligjore për pozicionin e shpallur me vendimin nr. 14. Pra relatori i përzgjedhur për të verifikuar procedurën për pozicionin 14, të jetë i njëjti relator për të vijuar më tej edhe procedurën për verifikimin e kritereve ligjore për pozicionin e shpallur me vendimin nr. 15, pasi siç thashë edhe një herë është i njëjti kandidat.

Këto janë dy kërkesat e mia.

Në dijeninë time, edhe kolegu im z. Toro ka për të bërë një kërkesë tjetër për të rimodifikuar rendin e ditës.

Faleminderit!

**Ilir Rusi:** Faleminderit zoti Kurushi!

Fjala për ju zoti Toro!

**Alban Toro:** Propozimi i radhës i KZHK-së do të ishte në lidhje me kandidaten {...} për të cilën sot aktualisht është përfshirë në rendin e ditës renditja e saj në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Në kushtet kur kemi të bëjmë me një kandidate, eventualisht kjo do të jetë e para nga pikëpamja matematikore dhe si e tillë them dhe propozoj që të shtohet në rendin e ditës edhe ngritja e saj në detyrën e gjyqtares së Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe njëkohësisht edhe përfundimi para afatit i shërbimit në skemën e delegimit për shkak se ajo aktualisht është në skemën e delegimit dhe me caktimin e saj në detyrë në të njëjtën gjykatë rezulton pa kuptim dhe pa sens të vijojë shërbimin në skemë delegimi për këtë gjykatë. Faleminderit!

**Ilir Rusi:** Faleminderit zoti Toro!

Ka diskutime apo parashpresa të tjera nga anëtarët në lidhje me rendin e ditës?

*(Nuk ka diskutime.)*

Atëherë, në kronologji, fillimisht hedhim në votim propozimin e zotit Kurushi.

**Dritan Hallunaj:** Dakord.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Yllka Rupa:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

***Klodian Kurushi:*** Dakord.

***Ilir Rusi:*** Dakord.

***Ilir Rusi:*** Vazhdojmë me votimin e propozimit të zotit Toro për të shtuar rendin e ditës në lidhje me çështjet të cilat u parashtruan nga ana e tij si relator.

***Dritan Hallunaj:*** Pro.

***Ridvan Hado:*** Dakord.

***Alban Toro:*** Dakord.

***Fatmira Luli:*** Dakord.

***Marçela Shehu:*** Dakord.

***Yllka Rupa:*** Pro.

***Brikena Ukperaj:*** Pro.

***Klodian Kurushi:*** Dakord.

***Ilir Rusi:*** Dakord.

***Ilir Rusi:*** Atëherë vazhdojmë me mbledhjen e ditës së sotme.

Si pikë e parë e saj me dyer të hapura do të jetë shqyrtimi i projektvendimit “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 287, datë 06.07.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej, fjalën relatorit z. Toro.

***Alban Toro:*** Faleminderit!

Në përpjekjet e KLGJ-së në plotësimin e vakancave në sistemin gjyqësor, në mënyrë konkrete për Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ky Këshill me vendimin nr. 287, datë 06.07.2021 ka hapur procedurat e ngritjes në detyrë për një pozicion të lirë në këtë gjykatë.

Kandidatja e vetme në këtë pozicion është zonja {...}, gjyqtare e Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, aktualisht gjyqtare e skemës së

delegimit e caktuar për një periudhë kohe në Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

Më herët nga ana e Këshillit janë verifikuar kriteret formale të parashikuara nga neni 8/3, 47/4, 48/8 dhe konkretisht përvoja profesionale minimale, mospasja masë disiplinore në fuqi, mosqenia në situatën e papajtueshmërisë ambientale, dhënia e pëlqimit (ai dhe familjarët e afërm) për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr. 95/2016, dhe pasuria dhe figura.

Me vendimin nr.359, datë 13.07.2023, vendosi kualifikimin e saj dhe vijimin e procedurave përkatëse për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë ku ajo ka kandiduar.

Krahas këtyre verifikimeve janë vijuar edhe vlerësimet me qëllim gradimi si dhe vlerësimi për periudhën 2017-2019, bazuar në vendimin e Këshillit 177, datë 29.04.2021.

Me vendimin nr. 372, datë 13.07.2023, filloi procedurën e përzgjedhjes për ngritjen në detyrë ku është caktuar edhe relatori përkatës.

Aktualisht nga ana e relatorit janë administruar vlerësimet etike dhe profesionale për kandidaten e vetme në këtë pozicion të lirë znj. {...}:

a) Sipas Vendimit të Këshillit nr. 118 datë 15.03.2023, kandidatja është vlerësuar për periudhën 2017-2019, në nivelin e përgjithshëm “Shumë mirë”, duke grumbulluar në total 372 pikë, sipas “Raportit të vlerësimit etik dhe profesional” bashkëlidhur këtij vendimi.

b) Sipas Vendimit të Këshillit nr. 117, datë 15.03.2023, kandidatja është vlerësuar/graduuar për periudhën e vlerësimit 2013-2016, në nivelin e përgjithshëm “Shkëlqyeshëm”, duke grumbulluar në total 391 pikë, sipas raportit bashkëlidhur.

Dy vlerësimet etike dhe profesionale të miratuara me Vendimet e Këshillit nr. 117, datë 15.03.2023 dhe nr. 118, datë 15.03.2023, nuk është paraqitur ankim dhe si të tillë kanë marrë formë të prerë.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të administruar, në kushtet kur në këtë procedurë ngritjeje në detyrë ka kandiduar vetëm një kandidat dhe, për rrjedhojë, edhe në procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve është vetëm një i tillë, u vlerësua se nuk ka vend për ndjekjen e hapave, kriterëve dhe përparësive sipas përcaktimeve të Kreut IV, të

Vendimit 70/2020. Për rrjedhim relatori përgatiti këtë projektvendim në dispozitivin e të cilit ju sugjerohet të miratoni:

1.Miratimin e renditjes së kandidatës në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 287, datë 06.07.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë:

1. Znj. {...}

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatës znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016, me ndryshimet përkatëse.

3. Kundër vendimit mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve, nga dita e njoftimit të vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

***Ilir Rusi:*** Faleminderit zoti Toro!

Ka diskutime nga anëtarët?

*(Nuk ka diskutime.)*

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

***Dritan Hallunaj:*** Pro.

***Ridvan Hado:*** Dakord.

***Alban Toro:*** Dakord.

***Fatmira Luli:*** Dakord.

***Marçela Shehu:*** Dakord.

***Yllka Rupa:*** Pro.

***Brikena Ukperaj:*** Pro.

***Klodian Kurushi:*** Dakord.

***Ilir Rusi:*** Dakord.

Vendim “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për

pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 287, datë 06.07.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse vendosi:

1. Miratimin e renditjes së kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 287, datë 06.07.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë:

1. Znj. {...}

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

3. Kundër vendimit mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve, nga dita e njoftimit të vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 2 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**







REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 17.07.2023)*

**Pika 3 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për hapjen e procedurës dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandimin në pozicionin e “ndihmësmagjistratit” në Gjykatën Kushtetuese”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, relator z. Klodian Kurushi.<sup>2</sup>

***Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:27 dhe mbaroi në orën 13.18.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                           |                          |
|---------------------------|--------------------------|
| <b>1. Ilir Rusi</b>       | <b>(zëvendëskryetar)</b> |
| <b>2. Klodian Kurushi</b> | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>3. Fatmira Luli</b>    | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>4. Dritan Hallunaj</b> | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>5. Ridvan Hado</b>     | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>6. Alban Toro</b>      | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>7. Marçela Shehu</b>   | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>8. Brikena Ukperaj</b> | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>9. Yllka Rupa</b>      | <b>(anëtare)</b>         |

<sup>2</sup> Kjo pikë ishte parashikuar të trajtohej e para sipas rendit të ditës.

*Shënim:* Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor *znj. Irena Plaku*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese e MD-së.*
- 5. Valbona Bala, Eksperte (EWMI).*
- 6. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*
- 7. Edmond Hoxhaj, BIRN.*

#### **RENDI I DITËS:**

3. Shqyrtimi i projektvendimit “Për hapjen e procedurës dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandimin në pozicionin e “ndihmësmagjistratit” në Gjykatën Kushtetuese”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, relator z. Klodian Kurushi.

*Illir Rusi:* Vazhdojmë me një pikë tjetër të rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për hapjen e procedurës dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandimin në pozicionin e “ndihmësmagjistratit” në Gjykatën Kushtetuese”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej, fjalën relatorit z. Kurushi.

*Klodian Kurushi:* Faleminderit!

Pa humbur kohë po filloj me prezantimin e relacionit.

Ligji “Për statusin” ka parashikuar mundësinë e komandimit të magjistratëve me pëlqimin e tyre në institucione të tjera brenda sistemit të drejtësisë, përfshirë këtu edhe

Gjykatën Kushtetuese, në pozicionin e “ndihmësmagjistratit”. Pikërisht Pika 1, e nenit 56, të Ligjit për Statusin përcakton se: “1. Magjistrati mund të komandohet në Gjykatën Kushtetuese, ..., me mandat pesëvjeçar, me të drejtë ripërsëritjeje, me kërkesë të institucionit ku komandohet magjistrati.”.

Në Ligjin nr. 8577, datë 10.02.2020 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, në nenin 14/a parashikohet se: “1. Pranë Gjykatës Kushtetuese funksionon Njësia e Shërbimit Ligjor, e cila përbën bërthamën shkencore juridike të Gjykatës Kushtetuese. ... 2. Njësia e Shërbimit Ligjor përbëhet nga këshilltarë ligjorë, të cilët emërohen nga Kryetari, nga radhët e juristëve që plotësojnë kriteret për të qenë gjyqtarë, prokurorë ose juristë me përvojë jo më pak se 10 vjet si lektorë të së drejtës, avokatë ose nëpunës të lartë të administratës publike. Jo më pak se gjysma e numrit të përgjithshëm të këshilltarëve ligjorë emërohen nga radhët e magjistratëve.

Sipas këtyre përcaktime ligjore, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor është paraqitur shkresa nr. 506 prot., datë 26.05.2023, protokolluar në Këshill me aktin nr. 3085 prot., datë 29.05.2023, e Gjykatës Kushtetuese, me objekt: “Kërkesë për komandimin e tre magjistratëve në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës Kushtetuese, në pozicionin “Këshilltar ligjor””. Përmes kësaj shkrese, Këshillit i është kërkuar komandimi i 3 (tre) magjistratëve gjyqtarë në pozicionin e “Këshilltarit ligjor” në Gjykatën Kushtetuese. Ndër të tjera në këtë shkresë është kërkuar: “Kriteret specifike që kërkon pozicioni i ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Kushtetuese, sipas nenit 14/a të ligjit nr. 8577/2000 dhe përshkrimit të punës së tyre janë të orientuara në funksionin këshillues dhe ndihmës që magjistrati i komanduar luan në procesin vendimmarrës të Gjykatës së Kushtetuese duke përfshirë: përgatitjen e çështjeve për gjykim, dhënien e opinionëve ligjore dhe përgatitjen e kërkimeve shkencore për çështjet gjyqësore që janë për shqyrtim para Gjykatës Kushtetuese. Në këtë drejtim, është e domosdoshme pasja e një përvoje profesionale minimale prej jo më pak se një vit, sikundër edhe specializimi i ngushtë i tyre, si në çështje të së drejtës së brendshme, ashtu edhe të asaj ndërkombëtare.

Vlerësimi i Komisionit:

Nëpërmjet kërkesës së mësipërme Gjykata Kushtetuese parashtron se: “... periudha për të cilën kërkohet të komandohen tre magjistratë në njësinë e shërbimit ligjor është jo më pak se 3 vjet.

Për sa më lart, mbështetur në nenet 53, 54, 56, 57 dhe 58 të Ligjit për Statusin, në pikën 2, të nenit 14/a, të Ligjit nr. 8577, datë 10.02.2020 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese” mbi kërkesën e Gjykatës Kushtetuese, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozon Këshillit të shpallë kërkesën për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Gjykatën Kushtetuese, për 3 (tre) pozicione të lira në pozicionin e “këshilltarit ligjor”, propozim për të cilin është përgatitur projektvendimi “Për hapjen e procedurës së komandimit në pozicionin e “ndihmësmagjistratit/ këshilltarit ligjor” në Gjykatën Kushtetuese dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve”.

Komisioni vlerëson se procedura të fillojë për hapjen e 3 (tre) pozicioneve; ky konkluzion vjen duke mbajtur në konsideratë organikën aktuale nga struktura organizative në gjykatat e shkallëve të para në raport me efektet që do të sjellë implementimi i hartës së re gjyqësore; ii) masat e ndërmarra së fundmi nga Këshilli për rastet e lëvizjeve paralele dhe transferimet e përkohshme; iii) si edhe emërimet e 40 magjistratëve që kanë përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin akademik 2022–2023.

Sipas këtij projektvendimi hapet procedura dhe shpallet kërkesa për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për plotësimin e pozicionit të “ndihmësmagjistratit/ këshilltarit ligjor” në Gjykatën Kushtetuese, sikundër përcaktohen afati, dokumentacioni, kohëzgjatja, kushtet dhe kriteret preferenciale të kandidimit, sikurse jepet dhe informacioni për procedurën e komandimit, në përputhje me kërkesat e pikës 3, të nenit 54, të Ligjit për Statusin.

Struktura e projektvendimit

Projektvendimi është i strukturuar në 2 Krerë.

Kreu I i projektvendimit, pikat 1 dhe 2, bëjnë fjalë për hapjen e procedurës dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura, për komandim në Gjykatën Kushtetuese, për 3 (tre) pozicione të lira si “ndihmësmagjistrat”.

Në pikën e tretë, lidhur me afatin e paraqitjes së kërkesave parashikohet se afati i paraqitjes së kërkesave për komandim është: opsioni i) 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga e nesërmja e shpalljes së këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor ose opsioni ii) deri në një datë fikse të caktuar në varësi të shqyrtimit nga

mbledhja plenare. Ne si Komision propozojmë datën 31 korrik. Është dita e fundit që parashikon ligji një afat prej jo më pak se 14 ditë dhe duke iu referuar mbledhjes së sotme dhe mundësisë së shpalljes së sotme në faqen zyrtare të thirrjes për kandidim, nga kjo ditë të filloj edhe llogaritja e afatit 14-ditor (që sipas llogaritjeve tona, afati i fundit 14-ditor i bie në datën 31 korrik). Pra deri në datën 31 korrik ne presim kandidaturat, kërkesat e kandidatëve gjyqtarë për shprehje interesi për t'u komanduar si ndihmësmagjistrat në Gjykatën Kushtetuese.

Në pikën 4 të këtij Kreu, përcaktohen dokumentet që duhet të paraqesë kandidati që do aplikojë në këtë procedurë.

Këto dokumente përfshijnë:

a) Kërkesa për shprehjen e interesit për të kandiduar për komandimin në pozicionin e ndihmësmagjistratit /këshilltarit ligjor në Gjykatën Kushtetuese

b) Jetëshkrimi, me të dhënat e plota të kontaktit (numër telefoni/e-mail), ku të pasqyrohet, veç të tjerash, çdo e dhënë e mundshme në lidhje me kushtet dhe kriteret preferenciale të komandimit;

c) Fotokopje të kartës së identitetit;

ç) Vetëdeklarim për mospasjen masë disiplinore në fuqi, sipas formularit bashkëlidhur këtij vendimi;

d) Vetëdeklarim për mosqenien në situatën e papajtueshmërisë ambientale;

dh) Vërtetim për përvojën profesionale minimale prej 1 (një) viti si magjistrat profili gjyqtar në fushën e të drejtës përkatëse dhe vërtetim nga gjykata/gjykatat për specializimin në fushën administrative, civile ose penale;

e) Lista e rezultateve të studimeve dhe karakteristika e Shkollës së Magjistraturës nëse disponohet;

ë) Vërtetim nga Shkolla e Magjistraturës për pjesëmarrjen në programin e formimit vazhdues dhe përfshirjen në veprimtaritë trajnuese si trajner, lehtësues, pjesëmarrës dhe veprimtari të tjera kualifikuese dhe trajnuese;

f) Certifikatë/dëshmi për gjuhën e huaj të një vendi të Bashkimit Evropian;

g) Tre dokumente ligjore, vendime gjyqësore, artikuj apo botime shkencore në fushën e jurisprudencës ku të pasqyrohet njohja e jurisprudencës; specializimi në fushën kushtetuese dhe të drejtave të njeriut do të konsiderohet avantazh;

gj) Njohja e jurisprudencës së Gjykatës së Strasburgut dhe asaj ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut do të konsiderohet avantazh;

h) Rekomandime si dhe çdo dokument tjetër për aftësitë e komunikimit;

i) Çdo dokument tjetër që tregon plotësimin nga kandidati të kriterëve të komandimit.

Në pikën 5 të këtij Kreu, përcaktohet vendi i dorëzimit të dokumentacionit, që është pranë Zyrës së Protokollit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në Kreun II të projektvendimit jepet informacion për kohëzgjatjen, kushtet, kriteret preferenciale dhe procedurën e komandimit.

Në pikën 6 të projektvendimit, përcaktohet se kohëzgjatja e komandimit, që është 3 (tre) vjet, me të drejtë ripërtëritje.

Në pikën 7 të tij, përcaktohet mundësia e përfundimit të komandimit përpara afatit të mësipërm, në këto raste:

a) me kërkesë të gjyqtarit të komanduar, për shkaqe të justifikuara;

b) kur vazhdimi i komandimit bie ndesh me interesat e lartë të gjykatës ku i komanduari ushtron funksionin e gjyqtarit;

c) kur ndaj gjyqtarit të komanduar merret masë disiplinore;

ç) kur gjyqtari i komanduar jep dorëheqjen nga statusi;

d) kur gjyqtari i komanduar largohet nga detyra;

Në vijim, në pikën 8 të projektvendimit listohen kushtet e komandimit, që janë: a) Komandimi nuk duhet të bjerë ndesh me interesat e lartë të gjykatës ku kandidati ushtron funksionin e gjyqtarit; b) Kandidati nuk duhet të jetë në një pozicion me mandat të kufizuar; c) Kandidati nuk duhet të jetë i komanduar; ç) Kandidati, që ka qenë i komanduar më parë: i) duhet të ketë shërbyer jo më pak se pesë vjet si gjyqtar pas përfundimit të periudhës së mëparshme të komandimit; ii) nuk duhet të ketë kaluar kohëzgjatjen maksimale të komandimit prej më shumë se dhjetë vjet gjatë gjithë kohës së ushtrimit të detyrës; d) Kandidati të mos ketë masë disiplinore në fuqi; dh) kandidati të mos jetë në kushtet e papajtueshmërisë ambientale për shkak të lidhjeve të ngushta familjare, me anëtarët e Gjykatës Kushtetuese, Sekretarin e Përgjithshëm, anëtarët e tjerë të Njësisë së Shërbimit Ligjor, sipas parashikimeve të nenit 8 pika 1 të Ligjit nr.96/2016.

Pasur parasysh kërkesën e Gjykatës Kushtetuese, duke pasur në konsideratë natyrën e pozicionit për të cilën kërkohet komandimi i gjyqtarëve, institucioni është shprehur se preferon që kandidatët të plotësojnë disa kritere specifike preferenciale, duke u bazuar në një sërë treguesish. Për rrjedhojë, në pikën 9 të projektvendimit përcaktohen kriteret preferenciale të komandimit e më konkretisht:

- a) Përvojë profesionale minimale prej 1 (një) viti dhe vërtetim nga gjykata/gjykatat për specializimin në fushën administrative, civile ose penale;
- b) Njohuri të jurisprudencës së gjykatave vendase dhe ndërkombëtare;
- c) Specializimi në fushën kushtetuese dhe të drejtave të njeriut do të konsiderohet avantazh;
- ç) Njohja e jurisprudencës së Gjykatës së Strasburgut dhe asaj ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut do të konsiderohet avantazh
- d) Rezultate të mira në studime, si dhe performanca në programin e formimit fillestar dhe vazhdues në Shkollën e Magjistraturës;
- dh) Njohuri të paktën në një gjuhë të vendeve të Bashkimit Evropian;
- e) Aftësi të mira të shkrimit dhe të arsyetimit ligjor;
- ë) Aftësi shumë të mira të komunikimit me shkrim dhe me gojë;

Në pikën 10 të projektvendimit përcaktohet dokumentacioni që do të shërbejë për vlerësimin nga Këshilli të kushteve të kandidimit, duke parashikuar që Këshilli mbështetet në dokumentacionin e paraqitur nga kandidati, si dhe në dokumentacionin e dosjes personale të kandidatit të administruar pranë Këshillit.

Në pikën 11 të projektvendimit, përcaktohet procedura e komandimit.

Kështu, fillimisht, nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, brenda dy javëve pas përfundimit të afatit të kandidimit, bëhet verifikimi dhe vlerësimi i plotësimin të kushteve të komandimit nga kandidatët që do të aplikojnë. Në këtë rast, Komisioni përgatit një projekt-opinion për çdo kandidat, në lidhje me qenien e komandimit në përputhje me interesat e lartë të gjykatës ku kandidati ushtron funksionin, projekt-opinione këto që më pas shqyrtohen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor jo më vonë se një javë pas njoftimit të Kryetarit të Këshillit për përgatitjen e tyre.

Sipas parashikimit të bërë në pikën 12 të projektvendimit, Këshilli i Lartë Gjyqësor i përcjell menjëherë për vlerësim Gjykatës Kushtetuese emrat e kandidatëve



që plotësojnë kushtet e komandimit për pozicionin e ndihmësmagjistratit, dokumentacionin e paraqitur nga ata në lidhje me kriteret preferenciale të komandimit, si dhe të dhënat mbi përvojën profesionale të tyre.

Në pikën 13 të projektvendimit, përcaktohet vijimi i procedurës së komandimit, ku Gjykata Kushtetuese, pasi vlerëson aplikimet e kandidatëve sa i përket kriterëve preferenciale, i kërkon Këshillit të Lartë Gjyqësor komandimin e magjistratit që ka përzgjedhur.

Më tej, sipas pikës 14 të projektvendimit, brenda dy javëve nga marrja e kërkesës, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendos për komandimin në pozicionin e ndihmësmagjistratit, të kandidatit të përzgjedhur nga Gjykata Kushtetuese.

Në pikën e fundit të projektvendimit, pikën 15, rregullohet situata ligjore kur asnjë prej kandidatëve nuk plotëson kushtet e komandimit apo kur asnjë prej tyre nuk përzgjidhet dhe kërkohet të komandohet nga Gjykata Kushtetuese. Në këtë rast, pas njoftimit të Gjykatës Kushtetuese dhe mbi kërkesën e saj, Këshilli i Lartë Gjyqësor mund të rishpallë kërkesën për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për pozicionin e “ndihmësmagjistratit” në Gjykatën Kushtetuese.

Së fundi, në projektvendim parashikohet hyrja në fuqi menjëherë e tij dhe botimi në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

***Ilir Rusi:*** Faleminderit zoti Kurushi!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

*(Nuk ka diskutime.)*

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

***Dritan Hallunaj:*** Pro.

***Ridvan Hado:*** Dakord.

***Alban Toro:*** Dakord.

***Fatmira Luli:*** Dakord.

***Marçela Shehu:*** Dakord.

***Yllka Rupa:*** Pro.

***Brikena Ukperaj:*** Pro.

***Klodian Kurushi:*** Dakord.

***Ilir Rusi:*** Dakord.

Vendim “Për hapjen e procedurës dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandimin në pozicionin e “ndihmësmagjistratit” në Gjykatën Kushtetuese”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse vendosi:

I. Hapjen e procedurës dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura

1. Hapjen e procedurës së komandimit të gjyqtarit në pozicionin e ndihmësmagjistratit Gjykatën Kushtetuese.

2. Shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Gjykatën Kushtetuese për 3 (tre) pozicione “ndihmësmagjistratit” në Njësinë e Shërbimit Ligjor në Gjykatën Kushtetuese.

3. Afati i paraqitjes së kërkesave për komandim deri në datë 31.07.2023.

4. Kandidati duhet të paraqesë këto dokumente:

a) Kërkesa për shprehjen e interesit për të kandiduar për komandimin në pozicionin e ndihmësmagjistratit në Gjykatën Kushtetuese

b) Jetëshkrimi, me të dhënat e plota të kontaktit (numër telefoni/e-mail), ku të pasqyrohet, veç të tjerash, çdo e dhënë e mundshme në lidhje me kushtet dhe kriteret preferenciale të komandimit;

c) Fotokopje të kartës së identitetit;

ç) Vetëdeklarim për mospasjen masë disiplinore në fuqi, sipas formularit bashkëlidhur këtij vendimi;

d) Vetëdeklarim për mosqenien në situatën e papajtueshmërisë ambientale me anëtarët e Gjykatës Kushtetuese, sekretarin e përgjithshëm, apo anëtarët e tjerë të Njësisë së Shërbimit Ligjor në Gjykatën Kushtetuese;

dh) Vërtetim nga gjykata/gjykatat për specializimin në fushën administrative, civile ose penale;

e) Lista e rezultateve të studimeve dhe karakteristika e Shkollës së Magjistraturës nëse disponohet;

ë) Vërtetim nga Shkolla e Magjistraturës për pjesëmarrjen në programin e

formimit vazhdues dhe përfshirjen në veprimtaritë trajnuese si trajner, lehtësues, pjesëmarrës;

- f) Certifikatë/dëshmi për gjuhën e huaj;
- g) Tre dokumente ligjore, vendime gjyqësore, artikuj apo botime shkencore në fushën e jurisprudencës ku të pasqyrohet njohja e jurisprudencës;
- gj) Njohja e jurisprudencës së Gjykatës së Strasburgut dhe asaj ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut do të konsiderohet avantazh;
- h) Rekomandime si dhe çdo dokument tjetër për aftësitë e komunikimit;
- i) Çdo dokument tjetër që tregon plotësimin nga kandidati të kriterëve të komandimit.

5. Dokumentacioni sipas pikës 4, i këtij vendimi, dorëzohet pranë Zyrës së Protokollit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

## II. Kohëzgjatja, kriteret dhe procedura e komandimit

6. Kohëzgjatja e komandimit është 3 (tre) vjet, me të drejtë ripërtëritje.

7. Kohëzgjatja e komandimit mund të përfundojë para afatit:

- a) me kërkesë të gjyqtarit, për shkaqe të justifikuara;
- b) kur vazhdimi i komandimit bie ndesh me interesat e lartë të gjykatës ku i komanduari ushtron funksionin e gjyqtarit;
- c) kur ndaj gjyqtarit të komanduar merret masë disiplinore;
- d) kur gjyqtari i komanduar jep dorëheqjen;
- e) kur gjyqtari i komanduar largohet nga detyra;

8. Kushtet e komandimit janë:

- a) Komandimi nuk duhet të bjerë ndesh me interesat e lartë të gjykatës ku kandidati ushtron funksionin e gjyqtarit;
- b) Kandidati nuk duhet të jetë në një pozicion me mandat të kufizuar;
- c) Kandidati nuk duhet të jetë i komanduar;
- ç) Kandidati, që ka qenë i komanduar më parë:
  - i) duhet të ketë shërbyer jo më pak se pesë vjet si gjyqtar pas përfundimit të periudhës së mëparshme të komandimit;
  - ii) nuk duhet të ketë kaluar kohëzgjatjen maksimale të komandimit prej më shumë se dhjetë vjet gjatë gjithë periudhës së ushtrimit të detyrës;

d) Kandidati të mos ketë masë disiplinore në fuqi.

dh) Kandidati të mos jetë në kushtet e papajtueshmërisë ambientale për shkak të lidhjeve të ngushta familjare, me anëtarët e Gjykatës Kushtetuese, sekretarin e përgjithshëm, anëtarët e tjerë të Njesisë së Shërbimit Ligjor, sipas parashikimeve të nenit 8 pika 1 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarit dhe prokurorit në Republikën e Shqipërisë”.

9. Kriteret preferenciale të komandimit:

a) Përvoja profesionale minimale prej 1 (një) viti dhe vërtetim nga gjykata/gjykatat për specializimin në fushën administrative, civile ose penale;

b) Njohuri të jurisprudencës së gjykatave vendase dhe ndërkombëtare;

c) Rezultate të mira në studime, si dhe performanca në programin e formimit fillestar dhe vazhdues në Shkollën e Magjistraturës;

ç) Njohuri të paktën në një gjuhë të vendeve të Bashkimit Evropian;

d) Aftësi të mira të shkrimit dhe të arsyetimit ligjor;

dh) Aftësi shumë të mira të komunikimit me shkrim dhe me gojë;

e) specializimi në fushën kushtetuese dhe të drejtave të njeriut do të konsiderohet avantazh.

10. Për vlerësimin e kushteve të kandidimit, Këshilli i Lartë Gjyqësor mbështetet në dokumentacionin e paraqitur nga kandidati, si dhe në dokumentacionin e dosjes së tij personale të administruar pranë Këshillit.

11. Brenda dy javëve pas përfundimit të afatit të kandidimit, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës përgatit një projekt-opinion për çdo kandidat dhe vlerëson nëse komandimi nuk është në përputhje me interesat e lartë të gjykatës ku kandidati ushtron funksionin. Projekt-opinionin për çdo kandidat shqyrtohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor jo më vonë se një javë pas njoftimit të Kryetarit të Këshillit për përgatitjen e tyre. Opinionet e miratuara nga Këshilli publikohen në faqen zyrtare të tij. Këshilli vendos përjashtimin e kandidatit nga komandimi kur komandimi nuk është në përputhje me interesat e lartë të gjykatës ku ai ushtron funksionin ose kur verifikohet që kandidati nuk plotëson ndonjë prej kushteve të tjera të komandimit.

12. Këshilli i Lartë Gjyqësor, i përcjell menjëherë për vlerësim Gjykatës Kushtetuese emrat e kandidatëve që plotësojnë kushtet e komandimit për pozicionin e

ndihmësmagjistratit, dokumentacionin e paraqitur nga ata në lidhje me kriteret preferenciale të komandimit, si dhe të dhënat mbi përvojën profesionale të tyre.

13. Gjykata Kushtetuese vlerëson aplikimet e kandidatëve dhe i kërkon Këshillit të Lartë Gjyqësor komandimin e magjistratit që ka përzgjedhur.

14. Brenda dy javëve nga marrja e kërkesës, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendos për komandimin në pozicionin e ndihmësmagjistratit, të kandidatit të përzgjedhur nga Gjykata Kushtetuese.

15. Nëse asnjë prej kandidatëve nuk plotëson kushtet e komandimit ose kur asnjë prej tyre nuk përzgjidhet nga Gjykata Kushtetuese, pas njoftimit dhe mbi kërkesën e kësaj të fundit, Këshilli i Lartë Gjyqësor mund të rihapë procedurën e komandimit të gjyqtarit në pozicionin e ndihmësmagjistratit në Gjykatën Kushtetuese.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 3 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 17.07.2023)*

**Pika 4 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 16, datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Dritan Hallunaj).<sup>3</sup>

***Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:27 dhe mbaroi në orën 13.18.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                           |                          |
|---------------------------|--------------------------|
| <b>1. Ilir Rusi</b>       | <b>(zëvendëskryetar)</b> |
| <b>2. Klodian Kurushi</b> | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>3. Fatmira Luli</b>    | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>4. Dritan Hallunaj</b> | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>5. Ridvan Hado</b>     | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>6. Alban Toro</b>      | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>7. Marçela Shehu</b>   | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>8. Brikena Ukperaj</b> | <b>(anëtare)</b>         |

<sup>3</sup> Kjo pikë ishte parashikuar të trajtohej e 2-ta sipas rendit të ditës.

**Shënim:** Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor *znj. Irena Plaku*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Luan Dibra, Maela Alicantaj, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese e MD-së.*
5. *Valbona Bala, Eksperte (EWMI).*
6. *Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*
7. *Edmond Hoxhaj, BIRN.*

#### **RENDI I DITËS:**

4. Shqyrtimi i projektvendimit “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 16, datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Dritan Hallunaj).

**Ilir Rusi:** Vazhdojmë me një pikë tjetër të rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 16, datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej, fjalën relatorit z. Hallunaj.

*Dritan Hallunaj:* Faleminderit!

Parashtroj relacionin për projektvendimin “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 16, datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Me disa vendime të datës 18.01.2023, Këshilli i Lartë Gjyqësor (më poshtë referuar si Këshilli) ka hapur katërmbëdhjetë procedura të lëvizjeve paralele në gjykatat e shkallës së parë, ndër to, me vendimin nr. 16 dhe nr. 18, procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile.

Afati i kandidimit u përcaktua data 01.02.2023.

Brenda afatit të kandidimit për këto dy pozicione ka kandiduar edhe z. {...}, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, aktualisht i transferuar përkohësisht në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë sipas vendimit të Këshillit nr. 95, datë 06.03.2023.

Mbas përfundimit të afatit të kandidimit për procedurat e lëvizjes paralele, mbi propozimin e Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, me vendimin nr.77, datë 13.02.2023, Këshilli miratoi listën e kandidatëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime etike dhe profesionale për efekt të kandidimit në procedurat e shpallura të lëvizjes paralele në gjykatat e shkallës së parë. Në këtë listë është përfshirë dhe z. {...}.

Më tej është caktuar relatori dhe është vijuar me procedurat e mëtejshme.

Për të evidentuar kandidatët që përmbushnin kriteret e kandidimit, të lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë në rastin konkret, Këshilli realizoi procedurat e verifikimit të plotësimit nga i vetmi kandidat të kriterëve të më poshtme:

- 1) “përvojës profesionale minimale”;
- 2) “mospasjes masë disiplinore në fuqi”;
- 3) “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

Kështu, për kandidatin e vetëm, z. {...}, në përfundim të fazës së parë të lëvizjes paralele në përputhje me parashikimet e Kreut V të vendimit 320/2020 Këshilli verifikoi plotësimin nga ai të kriterëve të kandidimit. Këshilli, me Vendimin nr. 186, atë



25.04.2023, vendosi kualifikimin e tij dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr.16 dhe nr. 18 datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kandidati {...} është tërhequr nga kandidimi i tij për pozicionin e shpallur me vendimin 18/2023 dhe Këshilli me vendimin nr. 309, datë 06.06.2023 ndër të tjera ka vendosur: “Përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 18, datë 18.01.2023, për shkak të tërheqjes së tij nga kandidimi për këtë pozicion.”

Me kualifikimin e kandidatit z. {...}, bazuar në pikën 75 Vendimit të Këshillit nr. 320, datë 19.02.2020, “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve”, Këshilli, me Vendimin nr. 294, datë 30.05.2023, vendosi fillimin e procedurave të përzgjedhjes të kandidatëve për lëvizje paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë edhe për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin e tij nr. 16, datë 18.01.2023. Relator i kësaj procedure jam përzgjedhur unë.

Më vonë është vazhduar me hapat procedural dhe në vijim të pikës 106, të vendimit të mësipërm, relatori ka administruar dokumentacionin përkatës për kandidatin e kualifikuar, që gjendej në dosjet e tyre personale apo në praktikën dokumentare të procedurave të verifikimit të plotësimit të kriterëve të kandidimit. Po ashtu, relatori ka administruar edhe vendimet përkatëse të Këshillit në lidhje me dy vlerësimet etike dhe profesionale për kandidatin e kualifikuar.

Konkretisht, lidhur me vlerësimet etike dhe profesionale, për kandidatin e vetëm z. {...} u konstatua se:

a) Sipas vendimit të Këshillit nr. 121, datë 15.03.2023, kandidati është vlerësuar për periudhën 2017-2019, në nivelin e përgjithshëm “Shkëlqyeshëm”, duke grumbulluar në total 391 pikë, sipas “Raportit të vlerësimit etik dhe profesional” të miratuar me këtë vendim.

b) Sipas vendimit të Këshillit nr. 351, datë 06.07.2023, kandidati është vlerësuar/graduuar për periudhën e vlerësimit 2013-2016, në nivelin e përgjithshëm “Shkëlqyeshëm”, duke grumbulluar në total 378 pikë, sipas “Raportit të vlerësimit etik dhe profesional” të miratuar me këtë vendim.

Dy vlerësimet etike dhe profesionale të kandidatit z. {...} të miratuara me Vendimet e Këshillit nr. 121, datë 15.03.2023 dhe nr. 351, datë 06.07.2023, u konstatuan të jenë bërë përfundimtarë, ndërsa ndaj tyre nuk është paraqitur ankim referuar deklaratës së kandidatit të dërguar në rrugë elektronike, datë 12.07.2023, përmes së cilës është shprehur se pasi u njoh me vendimin e Këshillit, deklaroi se nuk ka ankim ndaj tyre.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të administruar, në kushtet kur në këtë procedurë lëvizje paralele ka kandiduar vetëm një kandidat dhe, për rrjedhojë, edhe në procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve është vetëm një i tillë, u vlerësua se nuk ka vend për ndjekjen e hapave, kritereve dhe përparësive sipas përcaktimeve të Kreut VI, Seksioni B të vendimit 320/2020, në funksion të renditjes së kandidatëve. Nga ana tjetër, në respektim të përcaktimeve të Seksionit D, Kreu VI, të vendimit të mësipërm, relatori përgatiti projektvendimin “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 16, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Projektvendimi është i strukturuar në 3 pika.

Sipas pikës 1 të projektvendimit, Këshillit i propozohet të miratojë renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 16, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë: 1) Z. {...}.

Në pikën 2 të projektvendimit, përcaktohet se një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit Z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Në pikën 3 të projektvendimit përcaktohet se kundër vendimit mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve, nga dita e njoftimit të vendimit.

Së fundi, në projektvendimin përcaktohet se ky vendim botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Projektvendimi për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, u shqyrtua nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës në mbledhjen e datës 12.07.2023, ku pasi ka konstatuar si të plotë dokumentacionin e administruar për kandidaten në këtë

procedurë përzgjedhjeje, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në Këshillin e Lartë Gjyqësor. Faleminderit!

**Ilir Rusi:** Faleminderit zoti Hallunaj!

Ftoj anëtarët nëse kanë diskutime.

*(Nuk ka diskutime.)*

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Yllka Rupa:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Klodian Kurushi:** Dakord.

**Ilir Rusi:** Dakord.

Vendim “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 16, datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse vendosi:

1. Miratimin e renditjes së kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 16, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë:

1. Z. {...}.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

3. Kundër vendimit mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve, nga dita e njoftimit të vendimit.

Ky vendim botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 4 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

***PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR***

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 17.07.2023)*

***Pika 5 e rendit të ditës me objekt:*** Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 15 datë 18.01.2023, për kandidatin z. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).<sup>4</sup>

***Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:27 dhe mbaroi në orën 13.18.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                                  |                                 |
|----------------------------------|---------------------------------|
| <b><i>1. Ilir Rusi</i></b>       | <b><i>(zëvendëskryetar)</i></b> |
| <b><i>2. Klodian Kurushi</i></b> | <b><i>(anëtar)</i></b>          |
| <b><i>3. Fatmira Luli</i></b>    | <b><i>(anëtare)</i></b>         |
| <b><i>4. Dritan Hallunaj</i></b> | <b><i>(anëtar)</i></b>          |
| <b><i>5. Ridvan Hado</i></b>     | <b><i>(anëtar)</i></b>          |
| <b><i>6. Alban Toro</i></b>      | <b><i>(anëtar)</i></b>          |
| <b><i>7. Marçela Shehu</i></b>   | <b><i>(anëtare)</i></b>         |
| <b><i>8. Brikena Ukperaj</i></b> | <b><i>(anëtare)</i></b>         |

<sup>4</sup> Kjo pikë ishte parashikuar të trajtohej e 4-ta sipas rendit të ditës.

**Shënim:** Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor *znj. Irena Plaku*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Luan Dibra, Maela Alicantaj, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese e MD-së.*
5. *Valbona Bala, Eksperte (EWMI).*
6. *Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*
7. *Edmond Hoxhaj, BIRN.*

#### **RENDI I DITËS:**

5. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 15 datë 18.01.2023, për kandidatin z. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

**Ilir Rusi:** Vazhdojmë me një pikë tjetër të rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 15, datë 18.01.2023, për kandidatin z. {...}”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej, fjalën relatorit z. Kurushi

**Klodian Kurushi:** Faleminderit!

Me Vendimin nr.11 – nr.24, datë 18.01.2023 Këshilli i Lartë Gjyqësor (më poshtë referuar si Këshilli) ka vendosur hapjen e katërmbëdhjetë procedura të lëvizjes paralele në gjykatat e shkallës së parë, ndër to, me vendimin nr. 15, datë 18.01.2023, për procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile.

Brenda afatit të kandidimit për pozicionin e lirë nr.15, datë 18.01.2023 kandidoi edhe z. {...}, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë (aktualisht gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë).

Me vendimin nr. 115, datë 13.03.2023 “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë e Durrës...”, Këshilli ndër të tjera vendosi:

“I. Fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Rrethit gjyqësor Tiranë e Durrës, të shpallura me vendimet nr.11.; ;nr.24 ..., datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatët që kanë ose mund të kenë 2 (dy) vlerësime.”

Për z. {...} – relator u caktova unë z. Klodian Kurushi.

Në përfundim të procedurës së verifikimit për kandidatin z. {...} në lidhje me tre kriteret formale, konkretisht të kritereve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”, Këshilli, me vendimin nr. 201, datë 26.04.2023, ka vendosur:

1. Kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.12, nr.13 dhe nr.15, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Më datë 31.05.2023, në rrugë elektronike, në zbatim të pikës 75, Kreu VI, të vendimit të tij nr. 320, datë 17.09.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve”, kandidati u njoftua për vendimin nr. 294, datë 30.05.2023 “Për fillimin e procedurës së përzgjedhjes për lëvizje paralele.

Më datë 12.07.2023, kandidati z. {...}, ka paraqitur kërkesën për tërheqjen nga kandidimi për procedurën e lëvizjes paralele për pozicionin e lirë nr. 15, datë 18.01.2023. Ndër të tjera në këtë kërkesë ai parashtron se: “Me vullnetin tim të lirë dhe të plotë

deklaroj se tërhiqem nga kandidimi im në procedurën e lëvizjes paralele në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës civile të shpallur me vendimin nr. 15, datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Në rrethanat sa sipër, përgatitet ky relacion bazuar në pikën 107, Seksioni “D”, Kreun VI të vendimit të Këshillit nr. 320, datë 17.09.2020 “Për kriteret dhe procedurën e lëvizjes paralele të gjyqtarëve” ku përcaktohet se: “Në procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve për lëvizjen paralele janë të zbatueshme rregullat sipas pikave 54, 55, 59 dhe 60, të këtij vendimi.”; si dhe në pikën 108 Seksioni “DH” dhe në pikën 109 Seksioni “E”. Gjithashtu është mbajtur në konsideratë si dhe në pikën 59, Seksioni C, Kreun V, të Vendimit nr.320/2020 ku përcaktohet se: “Kur kandidati njofton tërheqjen nga kandidimi, relatori përgatit relacionin ku përshkruhen shkurtimisht veprimet e kryera dhe projektvendimin mbi përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele për atë kandidat, duke e dërguar menjëherë për shqyrtim përpara Komisionit.”

Faleminderit!

***Ilir Rusi:*** Faleminderit zoti Kurushi!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

*(Nuk ka diskutime.)*

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

***Dritan Hallunaj:*** Pro.

***Ridvan Hado:*** Dakord.

***Alban Toro:*** Dakord.

***Fatmira Luli:*** Dakord.

***Marçela Shehu:*** Dakord.

***Yllka Rupa:*** Pro.

***Brikena Ukperaj:*** Pro.

***Klodian Kurushi:*** Dakord.

***Ilir Rusi:*** Dakord.

Vendim “Për përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën



e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 15, datë 18.01.2023, për kandidatin z. {...}”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse vendosi:

1. Përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.15, datë 18.01.2023, për kandidatin z. {...}, për shkak të tërheqjes së tij nga kandidimi për këtë pozicion.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 5 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 17.07.2023)*

**Pika 6 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 15 datë 18.01.2023, për kandidaten znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Dritan Hallunaj).<sup>5</sup>

***Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:27 dhe mbaroi në orën 13.18.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Ilir Rusi** (zëvendëskryetar)
- 2. Klodian Kurushi** (anëtar)
- 3. Fatmira Luli** (anëtare)
- 4. Dritan Hallunaj** (anëtar)
- 5. Ridvan Hado** (anëtar)
- 6. Alban Toro** (anëtar)
- 7. Marçela Shehu** (anëtare)
- 8. Brikena Ukperaj** (anëtare)

<sup>5</sup> Kjo pikë ishte parashikuar të trajtohej e pesta sipas rendit të ditës.

**Shënim:** Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor *znj. Irena Plaku*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Luan Dibra, Maela Alicantaj, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese e MD-së.*
5. *Valbona Bala, Eksperte (EWMI).*
6. *Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*
7. *Edmond Hoxhaj, BIRN.*

#### **RENDI I DITËS:**

6. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 15 datë 18.01.2023, për kandidaten *znj. {...}*”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Dritan Hallunaj).

*Ilir Rusi:* Vazhdojmë me një pikë tjetër të rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 15, datë 18.01.2023, për kandidaten *znj. {...}*”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej, fjalën relatorit z. Hallunaj.

*Dritan Hallunaj:* Faleminderit!

Po parashtroj relacionin për tërheqjen e zonjës {...} nga kandidimi në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 15, datë 18.01.2023 të KLGJ-së.

Me Vendimet nr.11- nr.24, datë 18.01.2013 Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur hapjen e katërmbëdhjetë procedura të lëvizjes paralele në gjykatat e shkallës së parë, ndër to, me vendimin nr. 15, datë 18.01.2023 për procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile.

Brenda afatit të kandidimit ka kandiduar edhe znj. {...}, gjyqtare në Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier (aktualisht gjyqtare e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier).

Mbas përfundimit të afatit të kandidimit, Këshilli miratoi listën e kandidatëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime etike dhe profesionale për efekt të kandidimit në procedurat e shpallura të lëvizjes paralele në gjykatat e shkallës së parë. Në këtë listë është përfshirë dhe znj. {...}.

Me vendimin nr. 115, datë 13.03.2023, Këshilli ka vendosur:

“I. Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele të shpallura me vendimet nr.11.; ;nr.24, duke u caktuar unë si relator.

Në përfundim të procedurës së verifikimit për kandidaten znj. {...} në lidhje me tre kriteret formale, konkretisht të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”, të kandidimit të saj për lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionet e lira, me Vendimin nr. 179, datë 25.04.2023, është vendosur:

1. Kualifikimi i kandidatës {...} dhe vijimi i procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 15, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Më tej është vijuar me shortimin mbi kriteret e lëvizjes paralele dhe me këtë vendim, si relator i procedurës së përzgjedhjes për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 14, nr. 15, nr. 16 dhe nr. 20 jam caktuar unë si anëtar i KZHK-së.

Në vijim të procedurës së përzgjedhjes për këtë kandidate, me aktin nr. 6069 prot., datë 07.07.2023, kandidatja znj. {...}, ka paraqitur kërkesën për tërheqjen nga kandidimi për procedurën e lëvizjes paralele për pozicionin e lirë nr. 15, datë 18.01.2023, në fushën e të drejtës civile, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, protokolluar në Këshill me aktin nr. {...} prot., datë 11.07.2023, duke parashtruar se: “...shpreh vullnetin për të hequr dorë nga aplikimi për lëvizje paralele në pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile të gjyqtarit pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë të shpallur me vendimin nr. 15, datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor ...”.

Në këto rrethana, duke pasur parasysh edhe vendimmarrjen e Këshillit ku përcaktohet se: “Në procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve për lëvizjen paralele janë të zbatueshme rregullat sipas pikave 54, 55, 59 dhe 60, të këtij vendimi.”; ku ndër të tjera përcaktohet që: “Kur kandidati njofton tërheqjen nga kandidimi, relatori përgatit relacionin ku përshkruhen shkurtimisht veprimet e kryera dhe projektvendimin mbi përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele për atë kandidat, duke e dërguar menjëherë për shqyrtim përpara Komisionit.”

Duke vlerësuar të rregullt procedurën e verifikimit të ndjekur për znj. {...}, kandidate për lëvizjen paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, si dhe duke pasur parasysh kërkesën e saj për t’u tërhequr nga kandidimi për këtë pozicion, unë si relator ia parashtrova rastin Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

Ky Komision, më datë 11.07.2023, duke e konsideruar të rregullt procedurën e ndjekur për kandidaten znj. {...} vendosi që t’i dërgojë çështjen mbledhjes plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor për të vlerësuar dhe vendosur ky Këshill për përfundimin e kësaj procedure për lëvizjen paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për kandidaten znj. {...}, për shkak të tërheqjes së saj nga kandidimi.

Ju faleminderit!

***Ilir Rusi:*** Faleminderit zoti Hallunaj!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

*(Nuk ka diskutime.)*

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

***Dritan Hallunaj:*** Pro.

***Ridvan Hado:*** Dakord.

***Alban Toro:*** Dakord.

***Fatmira Luli:*** Dakord.

***Marçela Shehu:*** Dakord.

***Yllka Rupa:*** Pro.

***Brikena Ukperaj:*** Pro.

***Klodian Kurushi:*** Dakord.

***Illir Rusi:*** Dakord.

Vendim “Për përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 15, datë 18.01.2023, për kandidaten znj. {...}”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse vendosi:

1. Përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.15, datë 18.01.2023, për kandidaten znj. {...}, për shkak të tërheqjes së saj nga kandidimi për këtë pozicion.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 6 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 17.07.2023)*

**Pika 7 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan e Lezhe të shpallura me vendimet nr. 248, 249, 250, 251, 252, 253, 254, 255, datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

***Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:27 dhe mbaroi në orën 13.18.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                           |                          |
|---------------------------|--------------------------|
| <b>1. Ilir Rusi</b>       | <b>(zëvendëskryetar)</b> |
| <b>2. Klodian Kurushi</b> | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>3. Fatmira Luli</b>    | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>4. Dritan Hallunaj</b> | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>5. Ridvan Hado</b>     | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>6. Alban Toro</b>      | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>7. Marçela Shehu</b>   | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>8. Brikena Ukperaj</b> | <b>(anëtare)</b>         |

**Shënim:** Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor *znj. Irena Plaku*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Luan Dibra, {...}, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese e MD-së.*
5. *Valbona Bala, Eksperte (EWMI).*
6. *Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*
7. *Edmond Hoxhaj, BIRN.*

#### **RENDI I DITËS:**

7. Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan e Lezhe të shpallura me vendimet nr. 248, 249, 250, 251, 252, 253, 254, 255, datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

*Ilir Rusi:* Vazhdojmë me një pikë tjetër të rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan e Lezhe të shpallura me vendimet nr. 248, 249, 250, 251, 252, 253, 254, 255, datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej, fjalën relatorit z. Kurushi.



***Klodian Kurushi:*** Faleminderit!

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen plenare të datës 24.05.2023, hapi procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Elbasan e Lezhë, me vendimet nr. 248, 249, 250, 251, 252, 253, 254, 255, datë 24.05.2023.

Brenda afatit të kandidimit u paraqitën gjithsej 11 (njëmbëdhjetë) kandidatura, të cilët kanë aplikuar në procedurat e lëvizjes paralele për pozicionet e lira në fushën civile/penale në Gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Elbasan e Lezhë të prezantuar si më sipër.

Lidhur me verifikimin e kandidatëve që kandidojnë për lëvizjen paralele, Këshilli ka miratuar procedura të detajuara përmes vendimit nr. 320, datë 17.09.2020.

Për të vijuar më tej, Këshilli, me vendimin nr. 346, datë 27.06.2023, ndër të tjera ka vendosur: “Miratimin e listës së gjyqtarëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime, për efekt të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan e Lezhë dhe Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, të shpallura me vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor të sipërcituar, sipas Shtojcës I bashkëngjitur këtij vendimi.

Shtojca 1 përmban listën e gjyqtarëve që kanë 2 (dy) vlerësime ose që mund të kenë 2 (dy) vlerësime: 1. Z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër. 2. Z. {...}, gjyqtar i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër, pas datës 01.07.2023, gjyqtar i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë.

Sa i përket z. {...}, me kërkesën datë 12.07.2023 ai është drejtuar Këshillit për të kërkuar pension të parakohshëm. Komisioni vlerëson se duhet të fillojë procedura e verifikimit të kriterëve ligjore për lëvizjen paralele për këtë kandidat, procedurë e cila më tej do të kushtëzohet nga disponimi i Këshillit mbi kërkesën e tij për pensionin e parakohshëm.

Me vendimin nr. 346, datë 27.06.2023, Këshilli ka vendosur: “Miratimin e listës së gjyqtarëve që kanë ose mund të kenë një vlerësim, për efekt të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan e Lezhë dhe Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë,

të shpallura me vendimet e përmendura me lart, sipas Shtojcës II bashkëngjitur këtij vendimi.

Lista e gjyqtarëve që kanë 1 (një) vlerësim: Asnjë (zero) gjyqtar.

Lista e gjyqtarëve që mund të kenë 1 (një) vlerësim: 1. Znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër. 2. Znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë. 3. Z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër.

Lidhur me kandidaten znj. {...}, rezulton se kjo candidate ka aplikuar edhe më parë për lëvizje paralele, konkretisht ato të shpallura me vendimet nr. 14, 15, 17, datë 18.01.2023.

Gjyqtare znj. {...}, me kërkesën nr. 3741, datë 03.07.2023 ka shprehur vullnetin për heqje dorë nga kandidimet për pozicionet nr. 17, 250 dhe 252; gjithashtu me kërkesën datë 12.07.2023 deklaroi se heq dorë edhe nga aplikimi për pozicionin nr. 253. Në këto kushte kjo gjyqtare nuk konsiderohet më candidate për pozicionet e hapura për lëvizjen paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

Znj. {...} ka hequr dorë nga lëvizja paralele për pozicionin nr. 17 dhe vijon garën vetëm për pozicionet 19 dhe 22 (për pozicionin nr.22 është kualifikuar). Ajo është aplikante për pozicionin nr. 252.

Z. {...} ka hequr dorë nga pozicionet nr. 19 dhe nr. 23 dhe ka aplikuar për 2 pozicione të reja. Ai vijon garën vetëm për pozicionin nr. 22, ku dhe është kualifikuar.

Me kërkesën datë 11.07.2023, z. {...} deklaroi vullnetin e tij për heqjen dorë nga pozicioni nr. 250.

Po në vendimin nr. 346, datë 27.06.2023, Këshilli ka vendosur: “Miratimin e listës së gjyqtarëve që nuk kanë dhe nuk mund të kenë asnjë vlerësim, për efekt të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan e Lezhë dhe Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, të shpallura me vendimet e Këshillit të përmendura më lart, sipas Shtojcës III bashkëngjitur këtij vendimi.

Lista e gjyqtarëve që nuk kanë dhe nuk mund të kenë asnjë vlerësim: 1. Z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë. 2. Z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë. 3.

Znj.{...}, gjyqtare e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë.  
4. Znj.{...}, gjyqtare e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat.  
5. Znj.{...}, gjyqtare e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër.  
6. Znj.{...}, gjyqtare e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër.  
7. Znj.{...}, gjyqtare e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier.  
8. Z. {...}, gjyqtar i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, i transferuar përkohësisht në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, pas datës 01.07.2023 gjyqtar i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnje.  
9. Znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, e transferuar përkohësisht në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, pas datës 01.07.2023 gjyqtare e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnje.  
10. Znj.{...}, gjyqtare e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, aktualisht e komanduar si ndihmësmagjistrate në Gjykatën e Lartë.  
11. Znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, aktualisht e komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Në këto kushte, në përputhje me pikën 9 të vendimeve, nr. 248 - nr. 255 datë 24.05.2023, vendimin nr. 320, datë 17.09.2020, “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve”, Komisioni i propozon Këshillit të miratojë projektvendimin për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan e Lezhë të shpallura me vendimet nr. 248, 249, 250, 251, 252, 253, 254, 255, datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatët që kanë ose që mund të kenë dy vlerësime.

Ky kandidat i përket pozicioneve nr. 254 dhe nr. 255.

Sa i përket pozicioneve me kandidatë që kanë ose mund të kenë një vlerësim, në përputhje me pikën vijuese të vendimeve nr. 248 - nr. 255, datë 24.05.2023 dhe vendimit nr. 320, datë 17.09.2020, “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve” të Këshillit, Komisioni i propozon Këshillit të miratojë projektvendimin për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, të

shpallura me vendimet nr. 249, 250, 252, 253, datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatët që kanë ose mund të kenë një vlerësim.

Në këto pozicione janë kandidatët që mund të kenë 1 (një) vlerësim, konkretisht: Z. {...}, ka kandiduar në pozicionin nr. 249. Znj. {...}, ka kandiduar në pozicionin nr. 252.

Në këto kushte, në përputhje me pikën 9 të vendimeve, nr. 248 - nr. 253, datë 24.05.2023, vendimin nr. 320, datë 17.09.2020, “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve”, Komisioni i propozon Këshillit të miratojë projektvendimin për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan dhe Lezhë, të shpallura me vendimet nr. 248, 250, 251, 253, datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatët që nuk kanë dhe nuk mund të kenë asnjë vlerësim.

Lidhur me kandidatët që nuk kanë dhe nuk mund të kenë asnjë vlerësim paraqitet kjo situatë: - Për pozicionin nr. 248 z. {...} dhe znj. {...}; - Për pozicionin nr. 250 z. {...}. Ky i fundit në aplikimet e tij, si edhe në kërkesën drejtuar Këshillit me nr. {...} prot, datë 23.06.2023 ka shprehur preferencat e tij në pozicionet përkatëse: 1) Pozicioni nr. 255 në fushën e së drejtës penale në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë ; 2) Pozicioni nr. 254 në fushën e të drejtës civile në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë; 3) pozicioni nr. 250 në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan në fushën e të drejtës civile;

- Për pozicionin nr. 251 znj. {...} dhe z. {...}; - Për pozicionin nr. 253 znj. {...} dhe znj. {...}.

Projektvendimi është i strukturuar në 3 pika.

Në pikën e parë të vendimit parashikohet fillimi i procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, për kandidatët që kanë ose mund të kenë dy vlerësime.

Në pikën pasuese – caktimi i relatorit pas zhvillimit të procedurës së shortit për 1 kandidat, i cili sipas shtojcës I të vendimit nr. 346, datë 27.06.2023, ka ose mund të kenë 2 (dy) vlerësime

Në pikën e parë të vendimit parashikohet fillimi i procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për kandidatët që kanë ose mund të kenë një vlerësim.

Në pikën pasuese – caktimi i relatorit pas zhvillimit të procedurës së shortit për 2 kandidatët, të cilët sipas shtojcës II të vendimit nr. 346, datë 27.06.2023, kanë ose mund të kenë 1 (një) vlerësim.

Më tej parashikohet fillimi i procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për kandidatët që nuk kanë dhe nuk mund të kenë asnjë vlerësim, gjithsej 5 (pesë) kandidatë.

Lidhur me procedurën e shortit, do të jetë ajo e ndjekur në rastet e ngjashme. Në një enë të hidhen shiritat e letrës me emrat e anëtarëve të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, dhe në enën tjetër emrat e 8 (tetë) kandidatëve të cilët kanë aplikuar për procedurat e lëvizjes paralele. Më pas, shorti të vijojë me tërheqjen e një prej shiritave të letrës në enën me emrat e anëtarëve të Komisionit, i cili ngarkohet si relator për kandidatin përkatës të zgjedhur në vazon tjetër.

Komisioni propozon që secili prej anëtarëve të Komisionit të caktohet relator për 3 (tre) kandidatë dhe kryetari i komisionit për 2 (dy) kandidatë.

Së fundi, në projektvendim përcaktohet dhe hyrja në fuqi e tij, konkretisht menjëherë dhe shoqërohet me botimin në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

***Ilir Rusi:*** Po zoti Kurushi!

***Klodian Kurushi:*** Atëherë, pas relatimit, unë propozoj që të vijojë shorti ashtu sikundër u relatua në relacionin e prezantuar nga ana ime.

***Ilir Rusi:*** Ka diskutime për sa u parashtrua deri tani?

(Nuk ka diskutime.)

Le të vazhdohet me hedhjen e shortit.

Procedura e shortit si vijon:

Fillimisht futen në enën e qelqit shiritat e letrës me emrat e tre relatorëve: z. Klodian Kurushi, z. Alban Toro, z. Dritan Hallunaj.

Më tej futen në enën e dytë të qelqit shiritat e letrës me emrat e kandidatëve: {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}.

Procedura e përzgjedhjes:

Përzgjidhet emri i relatorit, z. Klodian Kurushi. Z. Kurushi do të jetë relator i kandidatëve të përzgjedhur nga shorti: znj. {...} dhe z. {...}.

Përzgjidhet emri i relatorit, z. Dritan Hallunaj. Z. Hallunaj do të jetë relator i kandidatëve të përzgjedhur nga shorti: znj. {...}, z. {...} dhe znj. {...}.

Përzgjidhet emri i relatorit, z. Alban Toro. Z. Toro do të jetë relator i kandidatëve të përzgjedhur nga shorti: znj. {...}, znj. {...} dhe z. {...}.

***Ilir Rusi:*** Faleminderit!

Ka diskutime për procedurën e deritanishme?

*(Nuk ka diskutime.)*

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit duke reflektuar edhe relatorët përkatës sipas shortit.

***Dritan Hallunaj:*** Pro.

***Ridvan Hado:*** Dakord.

***Alban Toro:*** Dakord.

***Fatmira Luli:*** Dakord.

***Marçela Shehu:*** Dakord.

***Yllka Rupa:*** Pro.

***Brikena Ukperaj:*** Pro.

***Klodian Kurushi:*** Dakord.

***Ilir Rusi:*** Dakord.

Vendim “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të

Përgjithshëm Elbasan e Lezhe të shpallura me vendimet nr. 248, 249, 250, 251, 252, 253, 254, 255, datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse vendosi:

I. Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, të shpallura me vendimet nr. 254; 255, datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatët që kanë ose mund të kenë 2 (dy) vlerësime.

1. Caktimin e relatorit si më poshtë:

1. Për kandidatin z. {...} - relator z. Dritan Hallunaj.

II. Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, të shpallura me vendimet nr. 249; 252, datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatët që kanë ose mund të kenë 1 (një) vlerësim.

2. Caktimin e relatorit si më poshtë:

1. Për kandidatin z. {...}- relator z. Alban Toro;

2. Për kandidaten znj. {...} - relator z. Klodian Kurushi;

III. Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, të shpallura me vendimet nr. 248, 250, 251, 253, datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatët që nuk kanë dhe nuk mund të kenë asnjë vlerësim.

1. Caktimin e relatorit si më poshtë:

1. Për kandidatin z. {...} - relator z. Dritan Hallunaj;

2. Për kandidatin z. {...} - relator z. Klodian Kurushi;

3. Për kandidaten znj. {...} - relator z. Dritan Hallunaj;

4. Për kandidaten znj. {...} - relator z. Alban Toro;

5. Për kandidaten znj. {...} - relator z. Alban Toro;

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor

\* \* \*

(Pika 7 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 17.07.2023)*

**Pika 8 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatës {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 21, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

***Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:27 dhe mbaroi në orën 13.18.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                           |                          |
|---------------------------|--------------------------|
| <b>1. Ilir Rusi</b>       | <b>(zëvendëskryetar)</b> |
| <b>2. Klodian Kurushi</b> | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>3. Fatmira Luli</b>    | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>4. Dritan Hallunaj</b> | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>5. Ridvan Hado</b>     | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>6. Alban Toro</b>      | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>7. Marçela Shehu</b>   | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>8. Brikena Ukperaj</b> | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>9. Yllka Rupa</b>      | <b>(anëtare)</b>         |

*Shënim:* Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor *znj. Irena Plaku*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese e MD-së.*
- 5. Valbona Bala, Eksperte (EWMI).*
- 6. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*
- 7. Edmond Hoxhaj, BIRN.*

#### **RENDI I DITËS:**

8. Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatës {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 21, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

*Gabimisht zoti Rusi lexon titullin e projektvendimit i cili në fillim të mbledhjes u votua për t’u hequr nga rendi i ditës (çështja me nr. 7 sipas rendit të ditës). Pas konstatimit, vijon mbledhja me çështjen e radhës.*

*Ilir Rusi:* Vazhdojmë me një pikë tjetër të rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatës {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me

vendimin nr. 21, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, me relator z. Kurushi.

***Në vijim edhe zoti Kurushi, gabimisht fillon të relatojë relacionin mbi projektvendimin e çështjes nr. 7 sipas rendit të ditës, e cila në fillim të mbledhjes u miratua që të hiqej nga rendi i ditës. Relacioni si vijon:***

“Në Mbledhjen Plenare të datës 18.01.2023, në ushtrim të funksionit kushtetues dhe ligjor për të siguruar mbarëvajtjen dhe administrimin e pushtetit gjyqësor, por edhe përgjegjësisë për të siguruar pavarësinë dhe përgjegjshmërinë e tij, me vendimet nr. 11; 12; 13; 14; 15; 16; 17; 18; 19; 20; 21; 22; 23 dhe 24, datë 18.01.2023 Këshilli i Lartë Gjyqësor hapi procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatat e rrethit gjyqësor Tiranë e Durrës. Pas përfundimit të afatit të kandidimit për këto procedura të lëvizjes paralele më datë 01.02.2023, rezultuan se u paraqitën gjithsej 36 (tridhjetë e gjashtë) kandidatura për pozicionet e lira fushën civile në Gjykatën e rrethit gjyqësor Tiranë e Durrës të prezantuar si më sipër.

Me vendimin nr. 115, datë 13.03.2023, Këshilli ka vendosur: “I. Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e rrethit gjyqësor Tiranë e Durrës, të shpallura me vendimet e përmendura më lart si dhe janë caktuar relatorët përkatës për secilin kandidat.

Këshilli me vendime respektive ka përfunduar procedurat e verifikimit për kandidatët që kanë ose mund të kenë 2 (dy) vlerësime dhe që kanë ose mund të kenë 1 (një) vlerësim. Në përfundim të këtyre vendimmarrjeve është vendosur -Kualifikimi i kandidatëve dhe vijimi i procedurës së lëvizjes paralele në pozicionet përkatëse.

Ndër të tjera:

Për pozicionin e shpallur me vendimin nr. 15 është e kualifikuar znj. {...}.

Pas kërkesës së znj. {...} për heqjen dorë nga kandidimi për pozicionin nr. 15, Këshilli me vendimin e sotëm 17.07.2023 ka vendosur: “Përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.15, datë 18.01.2023, për kandidaten znj. {...}, për shkak të tërheqjes së saj nga kandidimi për këtë pozicion.”

Rezulton se në pozicionin e shpallur me vendimin nr. 15, datë 18.01.2023 nuk ka kandidatë të mundshëm me 2 vlerësime për të vijuar konkurrimin.

Në rrethanat si më lart, Këshillit i duhet që të fillojë procedurën e verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjes paralele në Gjykatën shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Tiranë – pozicioni nr.15, për kandidatët që kanë ose mund të kenë 1(një) vlerësim. Në këtë pozicion ka aplikuar edhe z. {...}, i cili ka dy vlerësime; por për këtë kandidat Këshilli ka përcjellë renditjen për pozicionet (që e thamë, unë e tërhoqa) nr.12 dhe nr.13 datë 18.01.2023 ku ai rezulton i renditur i pari si dhe ka bërë edhe heqjen dorë nga pozicioni nr. 15.

Në kushtet e mësipërme, kur në pozicionin e shpallur me vendimin nr. 15, datë 18.01.2023 nuk ka më kandidatë që konkurrojnë me 2 vlerësimet, Këshilli duhet të vijojë procedurat për kandidatët me 1 (një) vlerësim.

Lidhur me verifikimin e kandidatëve që kandidojnë për lëvizjen paralele, Këshilli ka miratuar procedura të detajuara përmes vendimit të tij nr. 320, datë 17.09.2020.

Procedurat e lëvizjes paralele janë të parashikuara në kreun e katërt të vendimit nr. 15, datë 18.01.2023 të Këshillit.

Këshilli, me vendimin nr. 77, datë 13.02.2023 Këshilli ndër të tjera ka vendosur: “Miratimin e listës së gjyqtarëve që kanë ose mund të kenë një vlerësim.

*(Konstatohet nga anëtarët që po relatohet gabimisht relacioni i cili doli nga rendi i ditës).*

**Klodian Kurushi:** Ju kërkoj ndjesë edhe një herë për pjesën e relatimit që në fakt i referohej kandidates znj. {...}. Por duke pasur të njëjtën situatë të ngjashme, kam bërë relatimin që nuk duhej. Ndërkohë që tani po bëj relatimin për zonjën {...}. Po e fillojmë edhe një herë. Përmbajtja është e njëjtë me ato çfarë unë thashë më përpara.

Me vendimet e datës 18.01.2023, Këshilli i Lartë Gjyqësor hapi katërmbëdhjetë procedura të lëvizjeve paralele në gjykatat e shkallës së parë, ndër to, me vendimin nr. 21, procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile.

Në pozicionin nr. 21 që i referohet lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksioni të Përgjithshëm Durrës nuk kishte kandidatë të kualifikuar me 2 (dy) vlerësime / apo 1(një) vlerësim (pasi kandidati i kualifikuar më parë për këtë pozicion z. {...} kishte hequr dorë nga pozicion). Në këto rrethana Këshilli me vendimin nr. 342, datë 27.06.2023 ka vendosur: “Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurën e lëvizjeve paralele në Gjykatën shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Durrës, të shpallur me vendimin nr. 21, datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatët që nuk kanë asnjë vlerësim.” – dhe është caktuar relatori që në këtë rast për znj. {...} jam unë si relator i përzgjedhur me short për vijimin e procedurës për verifikimin e kriterëve ligjore për këtë candidate.

Më datë 27.06.2023, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në vendimin e Këshillit nr. 320, datë 17.09.2020, “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve” në rrugë elektronike, kandidatja u njoftua: i) për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit; ii) për caktimin e relatorit të kësaj procedure verifikimi; iii) për të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatorit të caktuar dhe/ose të çdo anëtari tjetër të Këshillit, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e këtij njoftimi.

Në vijim të procedurës së verifikimit, bazuar në pikën 55, Seksioni C, Kreu V, të vendimit 320/2020, përmes shkresave të veçanta, për kandidaten znj. {...} u kërkuar dhe u administruar informacioni i nevojshëm nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, si organi kompetent për krijimin dhe administrimin e dosjeve personale dhe regjistrin të gjyqtarëve, si dhe nga gjykata ku kandidatja ka ushtruar funksionin e gjyqtarit.

Pas verifikimit të kriterit të “përvojës profesionale minimale specifike” dhe të atij të “mospasjes masë disiplinore në fuqi”, Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, më datë 27.06.2023 përcolli informacionin dhe dokumentacionin përkatës të administruar për kandidaten znj. {...}, siç do të përshkruhet më poshtë.

Sa i përket kriterit të “përvojës profesionale minimale specifike” të kandidates në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë ku ajo ka kandiduar, pra në fushën e të drejtës civile, referuar gjykatës ku kandidatja ka ushtruar funksionin

e gjyqtarit, informacioni u kërkuar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksioni të Përgjithshëm Shkodër (-ish gjykata e rrethit gjyqësor Shkodër) dhe në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksioni të Përgjithshëm Tiranë (si e transferuar me pëlqim në ish-gjykatën e rrethit gjyqësor Krujë). Nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksioni të Përgjithshëm Shkodër informacioni i kërkuar është përcjellë nëpërmjet më datë 03.07.2023, siç do të përshkruhet më poshtë; ndërsa nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksioni të Përgjithshëm Tiranë më datë 11.07.2023.

Rezultatet e verifikimit të kritereve të kandidimit-

Për kandidaten znj. {...} u verifikua kriteri i “Përvojës profesionale specifike minimale”

“Përvoja profesionale specifike minimale” për lëvizjen paralele të gjyqtarit në gjykatën e shkallës së parë, në rastin konkret në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksioni të Përgjithshëm Durrës, gjen reflektim në shkronjën “a”, të pikës 5, të vendimit 21/2023, ku është parashikuar në pikën 6, të nenit 43, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: “Magjistrati nuk ka të drejtë të kandidojë në rast se gjatë pesë viteve të fundit nuk ka të paktën një vit përvojë profesionale në fushën përkatëse të së drejtës për pozicionin e lirë ...”.

Për verifikimin e kandidates në lidhje me plotësimin e këtij kriteri për lëvizjen paralele u mbajt parasysh se ajo ka kandiduar për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile të shpallur me vendimin 21/2023, çka do të thotë se kandidatja duhet të ketë të paktën një vit përvojë profesionale si gjyqtare në fushën e së drejtës civile gjatë pesë viteve të fundit para kandidimit.

Në lidhje me përvojën e profesionale, në kërkesën për shprehje interesi dhe në jetëshkrimin e dorëzuar nga kandidatja, evidentohet se ajo ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2019 dhe ka ushtruar detyrën pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër prej datës 29.01.2020. Në këtë gjykatë ushtron funksionin e gjyqtarit edhe aktualisht.

Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, Znj. {...}, ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli Jurist, pranë Universitetit të Tiranës në datë 19.07.2012. Ka përfunduar ciklin e dytë të studimeve Master në “E drejtë civile” pranë

Universitetit të Tiranës në vitin 2014 dhe ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2019. Me vendim nr. 7, datë 09.01.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor emërohet gjyqtare. Me vendim nr. 46, datë 29.01.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor caktohet në pozicion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Me vendim nr. 363, datë 14.09.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor transferohet përkohësisht për një periudhë deri në 1 vit, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë.

Me vendim nr. 400, datë 23.09.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor i përsëritet transferimi i përkohshëm pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, për një periudhë deri në datën 01.05.2023 dhe në vijim ushtron funksionin e gjyqtares pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër.

Vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit është 3 vite.

Znj. {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.

Në lidhje me përvojën specifike profesionale në pesë vitet e fundit, sipas informacionit të përcjellë nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, nga verifikimet e kryera, rezultoi se: “Gjyqtarja {...} sipas vendimit të Këshillit të Gjykatës Shkodër datë 04.02.2020 është gjyqtare e dhomës civile, seksioni civil; sipas vendimit të Këshillit të Gjykatës Shkodër datë 24.03.2021 është gjyqtare e dhomës civile, seksioni civil”; nga përgjigja e ish –gjykatës së rrethit gjyqësor Krujë rezultoi se: “Me urdhrin nr.{...} Prot. datë 06.01.2011 të Kryetares së Gjykatës “Për organizimin e punës në gjykatë” është urdhëruar se trupa gjyqësore do të gjykojë në tërësi çështje civile-penale për shkak se nuk mund të bëhej ndarja e saj në dhoma apo seksione, m.q.s. numri i gjyqtarëve nuk i përgjigjej ekzistencës më vete të dhomave penale apo civile. Që nga ajo datë, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë nuk ka pasur ndarje në dhoma apo seksione. Në këto kushte, edhe gjyqtare {...} ka gjykuar në tërësi çështje civile dhe penale.”

Nga dokumentacioni i përcjellë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, rezulton se vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit për kandidaten është 3 (tre)vite.

Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, kandidatja znj. {...}, deri në momentin e kandidimit për lëvizjen paralele, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 21, rezulton të ketë mbi një vit përvojë

profesionale specifike minimale si gjyqtare në fushën e së drejtës civile gjatë pesë viteve të fundit përpara kandidimit.

Për kandidaten znj. {...} u verifikua edhe kriteri i “mospasjes masë disiplinore në fuqi”.

Nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, nuk vërtetohet që kandidatja znj. {...} të ketë masë disiplinore në fuqi.

Për kandidaten znj. {...} u verifikua edhe kriteri i “papajtueshmërisë ambientale”.

Nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, për kandidaten znj. {...} nuk vërtetohet të ndodhet në situatën e papajtueshmërisë ambientale në rast të transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

Meqenëse kandidatja plotëson kriteret formale ligjore, ne propozojmë kualifikimin e kandidates znj. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 21, datë 18.01.2023. Një kopje e këtij vendimi t’i njoftohet kandidates sipas kërkesave të nenit 98 të ligjit 115/2016 dhe ky vendim të hyjë në fuqi dhe të publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë gjyqësor.

Faleminderit!

***Ilir Rusi:*** Faleminderit zoti Kurushi!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

*(Nuk ka diskutime.)*

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit përkatës.

***Dritan Hallunaj:*** Pro.

***Ridvan Hado:*** Dakord.

***Alban Toro:*** Dakord.

***Fatmira Luli:*** Dakord.

***Marçela Shehu:*** Dakord.

***Yllka Rupa:*** Pro.

***Brikena Ukperaj:*** Pro.

***Klodian Kurushi:*** Dakord.



***Ilir Rusi:*** Dakord.

Vendim “Për kualifikimin e kandidates {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 21, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse vendosi:

1. Kualifikimin e kandidates {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 21, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 8 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 17.07.2023)*

**Pika 9 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 21, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Dritan Hallunaj).

***Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:27 dhe mbaroi në orën 13.18.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                           |                          |
|---------------------------|--------------------------|
| <b>1. Ilir Rusi</b>       | <b>(zëvendëskryetar)</b> |
| <b>2. Klodian Kurushi</b> | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>3. Fatmira Luli</b>    | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>4. Dritan Hallunaj</b> | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>5. Ridvan Hado</b>     | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>6. Alban Toro</b>      | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>7. Marçela Shehu</b>   | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>8. Brikena Ukperaj</b> | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>9. Yllka Rupa</b>      | <b>(anëtare)</b>         |

*Shënim:* Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor *znj. Irena Plaku*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese e MD-së.*
- 5. Valbona Bala, Eksperte (EWMI).*
- 6. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*
- 7. Edmond Hoxhaj, BIRN.*

#### **RENDI I DITËS:**

9. Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 21, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Dritan Hallunaj).

*Ilir Rusi:* Vazhdojmë me shqyrtimin e një pike tjetër të rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 21, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, me relator z. Hallunaj.

*Dritan Hallunaj:* Faleminderit!

Po parashtroj relacionin për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e tre kritereve ligjore të kandidimit për lëvizjen paralele, të kandidatit z. {...}.

Me disa vendime të datës 18.01.2023, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka hapur katërmbëdhjetë procedura të lëvizjeve paralele në gjykatat e shkallës së parë, ndër to, me vendimin nr. 21, procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile, duke përcaktuar edhe afatin e kandidimit që ishte data 01.02.2023.

Brenda afatit të kandidimit ka kandiduar edhe z. {...}, aktualisht gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksioni të Përgjithshëm Dibër.

Në pozicionin nr. 21 që i referohet lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksioni të Përgjithshëm Durrës nuk kishte kandidatë të kualifikuar me 2 (dy) vlerësime / apo 1 (një) vlerësim (pasi kandidati i kualifikuar më parë për këtë pozicion z. Arapi kishte hequr dorë nga pozicion). Në këto rrethana, me vendimin nr. 342, datë 27.06.2023 Këshilli ka vendosur: “Fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit në procedurën e lëvizjeve paralele në Gjykatën shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Durrës, të shpallur me vendimin nr. 21, datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, duke u caktuar unë si relator i kësaj procedure.

Më tej është njoftuar kandidati që kishte të drejtë për përjashtimin e relatorit të caktuar dhe/ose të çdo anëtari tjetër të Këshillit, të cilat janë bërë në dijeni brenda afatit ligjor dhe nuk ka shfaqur ndonjë pretendim në lidhje me sa u kërkua.

Për verifikimin e kritereve të “përvojës profesionale minimale specifike” dhe atij të “mospasjes masë disiplinore në fuqi”, Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, më datë 27.06.2023 përcolli informacionin dhe dokumentacionin përkatës të administruar të cilin do ta citoj më poshtë.

Gjithashtu për “përvojës profesionale minimale specifike” është referuar gjykatës ku kandidati ka ushtruar funksionin e gjyqtarit, Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksioni të Përgjithshëm Dibër.

Lidhur me rezultatet e verifikimit të kritereve të kandidimit, për kandidatin u verifikua pasja e përvojës profesionale specifike minimale.

Pasja e përvojës profesionale specifike minimale për lëvizjen paralele të gjyqtarit në gjykatën e shkallës së parë, në rastin konkret në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksioni të Përgjithshëm Durrës, gjen reflektim në vendimin 21/2023, ku përcaktohet se: “Magjistrati nuk ka të drejtë të kandidojë në rast se gjatë pesë viteve të fundit nuk ka të paktën një vit përvojë profesionale në fushën përkatëse të së drejtës për pozicionin e lirë ...”.

Për verifikimin e kandidatit në lidhje me plotësimin e këtij kriteri për lëvizjen paralele u mbajt parasysh se ai ka kandiduar për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, çka do të thotë se kandidati duhet të ketë të paktën një vit përvojë profesionale si gjyqtar në fushën e së drejtës civile gjatë pesë viteve të fundit para kandidimit.

Në lidhje me përvojën e profesionale, në kërkesën për shprehje interesi dhe në jetëshkrimin e kandidatit, evidentohet se ai ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2019 dhe ka ushtruar detyrën pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër prej 29.01.2020. Në këtë gjykatë ushtron funksionin e gjyqtarit edhe aktualisht.

Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, kandidati z. {...}, ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli Jurist, pranë Universitetit “Luigj Gurakuqi” në datë 05.10.2012 dhe ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2019. Me vendim nr. 12, datë 09.01.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor emërohet gjyqtare. Me vendim nr. 56, datë 29.01.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor caktohet në pozicion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

Vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit është 3 vite.

Zoti {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.

Në lidhje me përvojën specifike profesionale në pesë vitet e fundit, sipas informacionit të përcjellë nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksioni të Përgjithshëm Dibër, nga verifikimet e kryera, rezultoi se: “Gjyqtari {...} ka gjykuar të gjitha kategoritë e çështjeve penale, civile, familjare dhe tregtare në kushtet kur gjykata për shkak të numrit të vogël të gjyqtarëve nuk ka qenë e ndarë në seksione apo dhoma të veçanta penale dhe civile.”

Nga dokumentacioni i përcjellë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe

Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, rezulton se vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit për kandidatin është 3 (tre) vite.

Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, kandidati z. {...}, deri në momentin e kandidimit për lëvizjen paralele, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 21, datë 18.01.2023, rezulton të ketë mbi një vit përvojë profesionale specifike minimale në fushën e së drejtës civile gjatë pesë viteve të fundit përpara kandidimit.

Për sa i përket kriterit të dytë që është kriteri i “mospasjes masë disiplinore në fuqi” është përcjellë informacioni nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit si dhe deklarimi i kandidatit. Rezulton që nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, nuk vërtetohet që kandidati z. {...} të ketë masë disiplinore në fuqi.

Gjithashtu është verifikuar edhe kriteri i “papajtueshmërisë ambientale”.

Në përfundim, nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, për kandidatin z. {...} nuk vërtetohet të ndodhet në situatën e papajtueshmërisë ambientale në rast të transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

Në këto kushte, duke e vlerësuar të plotë procedurën e verifikimit paraprak për kandidatin z. {...} në lidhje me kriteret ligjore të kandidimit të tij për lëvizjen paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, unë si relator ia parashtrova këtë Komisionit të Zhvillimit të Karrierës dhe ky Komision, më datë 11.07.2023, duke konsideruar të plotë procedurën e verifikimit për kriteret ligjore të kandidimit të z. {...}, vendosi që të kalojë për shqyrtim mbledhjes plenare për të vlerësuar dhe vendosur për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 21, datë 18.01.2023.

Faleminderit!

*Ilir Rusi*: Faleminderit zoti Hallunaj!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

*(Nuk ka diskutime.)*

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit përkatës.

***Dritan Hallunaj:*** Pro.

***Ridvan Hado:*** Dakord.

***Alban Toro:*** Dakord.

***Fatmira Luli:*** Dakord.

***Marçela Shehu:*** Dakord.

***Yllka Rupa:*** Pro.

***Brikena Ukperaj:*** Pro.

***Klodian Kurushi:*** Dakord.

***Illir Rusi:*** Dakord.

Vendim “Për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 21, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse vendosi:

1. Kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 21, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor

\* \* \*

(Pika 9 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 17.07.2023)*

**Pika 10 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatës {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.21, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

***Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:27 dhe mbaroi në orën 13.18.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
2. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
3. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
4. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
5. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
6. ***Alban Toro*** (anëtar)
7. ***Marçela Shehu*** (anëtare)
8. ***Brikena Ukperaj*** (anëtare)
9. ***Yllka Rupa*** (anëtare)



*Shënim:* Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor *znj. Irena Plaku*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese e MD-së.*
- 5. Valbona Bala, Eksperte (EWMI).*
- 6. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*
- 7. Edmond Hoxhaj, BIRN.*

#### **RENDI I DITËS:**

10. Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatës {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.21, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

*Ilir Rusi:* Vazhdojmë me një pikë tjetër të rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatës {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.21, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej, fjalën relatori z. Toro.

***Alban Toro:*** Faleminderit!

Nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor, më herët janë hapur disa procedura të lëvizjes paralele në gjykatat Tiranë dhe Durrës (shkalla e parë e juridiksionit të përgjithshëm). Një gjyqtare konkurruese është gjyqtarja {...} e cila ka kandiduar për pozicionet e lira nga 11–24, 18.01.2023, të hapura me vendimet përkatëse të Këshillit.

Konform pikës 5 të nenit 43 dhe pikës 6 të nenit 48 të Ligjit nr. 96/2016 kjo gjyqtare ka përcaktuar përfundimisht pozicionin nr. 21, datë 18.01.2023 si pozicion për të cilin konkurron.

Për këtë janë marrë disa vendime nga ana e Këshillit.

Me Vendimin nr. 342, datë 27.06.2023, ka filluar procedurat e verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit në procedurën e lëvizjeve paralele në Gjykatën shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Durrës, të shpallur me vendimin nr. 21 datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatët që nuk kanë asnjë vlerësim. (*ripërsëritet*).

Në kuadër të verifikimit të përvojës profesionale specifike minimale ku në përputhje me pikën 6, të nenit 43, të Ligjit për Statusin, ku ndër të tjera përcaktohet se: “Magjistrati nuk ka të drejtë të kandidojë në rast se gjatë pesë viteve të fundit nuk ka të paktën një vit përvojë profesionale në fushën përkatëse të së drejtës për pozicionin e lirë ...” është verifikuar kjo eksperiencë në përputhje me aktet të cilat janë administruar.

Për verifikimin e kandidates në lidhje me plotësimin e këtij kriteri për lëvizjen paralele u mbajt parasysh se ajo ka kandiduar për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile të shpallur me vendimin nr. 21, datë 18.01.2023, çka do të thotë se kandidatja duhet të ketë të paktën një vit përvojë profesionale si gjyqtare në fushën e së drejtës civile gjatë pesë viteve të fundit para kandidimit.

Në lidhje me përvojën e përgjithshme profesionale, në kërkesat për shprehje interesi dhe në jetëshkrimin e dorëzuar nga kandidatja, evidentohet se ajo ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli Jurist, pranë Universitetit të Tiranës në datë 09.07.2009, si dhe ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2020. Ndërkohë ajo është emëruar me vendimin nr. 476, datë 20.10.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor si dhe me vendimin nr. 511, datë 27.10.2020 të Këshillit ajo caktohen në pozicion në Gjykatës

së Rrethit Gjyqësor Berat. Në vijim, nga data 01.05.2023 ushtron funksionin e gjyqtares në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat.

Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, kandidatja znj. {...} ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli Jurist, pranë Universitetit të Tiranës në datë 09.07.2009, si dhe ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2020. Ndërkohë ajo është emëruar me vendimin nr. 476, datë 20.10.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor si dhe me vendimin nr. 511, datë 27.10.2020 të Këshillit ajo caktohet në pozicion në Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat. Në vijim, nga data 01.05.2023 ushtron funksionin e gjyqtares në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat. Vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit është 2 vite. Znj. {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.

Në lidhje me përvojën specifike profesionale, sipas informacionit të përcjellë nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, nga verifikimet e kryera, rezulton se prej periudhës 04.11.2013 me urdhrin nr. 93 të Kryetarit të Gjykatës është vendosur shkrirja e dhomës civile dhe penale në një dhomë të vetme. Në lidhje me gjyqtaren {...} rezulton se kandidatja: për periudhën 2020-2023 ka gjykuar si gjyqtare e seksionin të të miturve në konflikt me ligjin përcaktuar me urdhër nr. {...}, datë 16.12.2020; urdhër nr. {...}, datë 16.12.2020; urdhër nr. {...}, datë 05.07.2021; urdhër nr. {...} datë 18.01.2022; urdhër nr. {...}, datë 12.05.2022; urdhër nr. {...} datë 17.01.2023, referuar tabelave bashkëlidhur informacionit të përcjellë nga Gjykata, znj. {...} për periudhën tetor 2020-mars 2023 ka gjykuar në total 1423 çështje.

Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, kandidatja znj. {...}, deri në momentin e kandidimit për lëvizjen paralele, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 21 datë 18.01.2023, rezulton të ketë mbi një vit përvojë profesionale specifike minimale si gjyqtare në fushën e së drejtës civile.

Për kandidaten znj. {...} u verifikuan edhe kriteret e parashikuara nga nenet 8/3 dhe 48/8 të ligjit “Për statusin”, pra u verifikuar kriteri i “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe nuk rezulton të ketë një të tillë që ta pengojë për konkurrimin e mëtejshëm, gjithashtu për zonjën {...} u verifikua edhe kriteri i “Papajtueshmërisë ambientale”. Edhe

ky kriter nuk është provuar të ekzistojë dhe si e tillë nuk mund të ndalojë konkurrimin e mëtejshëm të saj.

Përfundimisht nga ana e relatorit u përgatit ky projektvendim, në dispozitivin e të cilit ju sugjerohet të miratoni:

1. Kualifikimin e kandidates {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 21, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

***Ilir Rusi:*** Faleminderit zoti Toro!

Ka diskutime nga anëtarët?

*(Nuk ka diskutime.)*

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

***Dritan Hallunaj:*** Pro.

***Ridvan Hado:*** Dakord.

***Alban Toro:*** Dakord.

***Fatmira Luli:*** Dakord.

***Marçela Shehu:*** Dakord.

***Yllka Rupa:*** Pro.

***Brikena Ukperaj:*** Pro.

***Klodian Kurushi:*** Dakord.

***Ilir Rusi:*** Dakord.

Vendim “Për kualifikimin e kandidates {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 21, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse vendosi:

1. Kualifikimin e kandidates {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 21, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 10 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 17.07.2023)*

**Pika 11 shtesë e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimeve “Për ngritjen në detyrën e gjyqtares së Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar të znj. {...}” dhe “Për përfundimin para afatit të shërbimit në skemën e delegimit, për gjyqtaren znj. {...}”, të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

***Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:27 dhe mbaroi në orën 13.18.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
2. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
3. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
4. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
5. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
6. ***Alban Toro*** (anëtar)
7. ***Marçela Shehu*** (anëtare)
8. ***Brikena Ukperaj*** (anëtare)
9. ***Yllka Rupa*** (anëtare)

*Shënim:* Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor *znj. Irena Plaku*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese e MD-së.*
- 5. Valbona Bala, Eksperte (EWMI).*
- 6. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*
- 7. Edmond Hoxhaj, BIRN.*

#### **RENDI I DITËS:**

11 shtesë. Shqyrtimi i projektvendimeve “Për ngritjen në detyrën e gjyqtares së Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar të znj. {...}” dhe “Për përfundimin para afatit të shërbimit në skemën e delegimit, për gjyqtaren znj. {...}”, të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

*Ilir Rusi:* Në vijim të mbledhjes, ashtu sikundër u vendos, njëkohësisht edhe për shkak të konfirmimit të marrë në vijim të vendimmarrjes që morëm ne si Këshill në lidhje me renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 287, datë 06.07.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në lidhje me zonjën {...}, është dërguar e-maili po ditën e sotme në orën 11:45 dhe në orën 11:50, po ditën e sotme, ka konfirmuar marrjen e këtij e-maili. Gjithashtu ka bërë me dije se nuk ushtron ankim ndaj këtij vendimi.

Në vijim vazhdojmë me shqyrtimin e projektvendimit në lidhje me ngritjen në

detyrë të gjyqtares të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, znj. {...}.

***Alban Toro:*** Faleminderit!

Pak minuta më përpara, nga ana e Këshillit është proceduar me vendimin për renditjen e kandidatëve, me nr. 380, datë 17.07.2023, ku vendosi miratimin e renditjes së kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 287, datë 06.07.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor si më poshtë, e vetme kandidate zonja {...}.

Vendimi sipas pikës 16 të këtij relacioni, më datë 17.07.2023, iu njoftua rregullisht kandidates znj. {...}, e cila, bazuar në pikën 10, të nenit 48, të Ligjit për Statusin, gëzonte të drejtën e ankimit ndaj këtij vendimi.

Kjo e fundit, në rrugë elektronike, më datë 17.07.2023 pasi konfirmoi marrjen dijani të vendimit, ka konfirmuar se nuk ka ankim ndaj vendimit.

*(Ripërsëritet edhe një herë fillimi i relatimit të këtij relacioni për shkak të një defekti teknik.)*

Në kushtet kur kandidatja e vetme ka konfirmuar marrjen e Vendimit për Renditjen e Kandidatëve nr.380, datë 17.07.2023, si dhe ka deklaruar se nuk kanë ankim ndaj tij, ky vendim konsiderohet se ka marrë formë të prerë.

Në këto kushte, nga ana e relatorit u përgatit ky projektvendim i cili në fakt ky relacion shoqërohet me dy projektvendime: së pari ju sugjerohet të miratoni:

1. Ngritjen në detyrën e gjyqtares së Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar të znj. {...}.

2. Efektet juridike të këtij vendimi fillojnë menjëherë.

3. Një kopje e vendimit i njoftohet znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr.115/2016, Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.



Për shkak të këtij vendimi pra faktit që ajo është caktuar në mënyrë të përhershme pranë kësaj gjykate ku ajo më parë ushtronte shërbimin për shkak të skemës së delegimit po pranë kësaj gjykate, rezulton që është e panevojshme të ushtrojë më tej, ndërkohë që ajo vazhdon të jetë gjyqtare e përhershme e kësaj gjykate, pas këtij vendimi, nga ana e relatorit u përgatit projektvendimi që do të shoqërojë këtë relacion: “Për përfundimin para afatit të shërbimit në skemën e delegimit, për gjyqtaren znj. {...}”:

1. Përfundimin para afatit të shërbimit në skemën e delegimit, për gjyqtaren znj. {...}.

2. Efektet e këtij vendimi fillojnë më datë 17.07.2023.

3. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtares znj. {...} sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016, Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë dhe Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

***Ilir Rusi:*** Faleminderit zoti Toro!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

*(Nuk ka diskutime.)*

Atëherë, referuar standardit të mbajtur në këto raste, në lidhje me efektet e fillimit të vendimit për ngritjen në detyrë të gjyqtares së Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, znj. {...}, do të fillojnë më datë 17.07.2023.

Ka diskutime për sa u parashtrua deri tani?

*(Nuk ka diskutime.)*

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit “Për ngritjen në detyrën e gjyqtares së Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar të znj. {...}”.

***Dritan Hallunaj:*** Pro.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Yllka Rupa:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Klodian Kurushi:** Dakord.

**Ilir Rusi:** Dakord.

Vendim “Për ngritjen në detyrën e gjyqtares së Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar të znj. {...}”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse vendosi:

1. Ngritjen në detyrën e gjyqtares së Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar të znj. {...}.

2. Efektet juridike të këtij vendimi fillojnë më datë 17.07.2023.

3. Një kopje e vendimit i njoftohet znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**Ilir Rusi:** Vazhdojmë me votimin e projektvendimit “Për përfundimin para afatit të shërbimit në skemën e delegimit, për gjyqtaren znj. {...}”.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Yllka Rupa:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Klodian Kurushi:** Dakord.

***Ilir Rusi:*** Dakord.

Vendim “Për përfundimin para afatit të shërbimit në skemën e delegimit, për gjyqtaren znj. {...}”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse vendosi:

1. Përfundimin para afatit të shërbimit në skemën e delegimit, për gjyqtaren znj. {...}.

2. Efektet e këtij vendimi fillojnë më datë 17.07.2023.

3. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarës znj. {...} sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë dhe Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

***Ilir Rusi:*** Me shqyrtimin e kësaj pike, mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

\* \* \*

(Pika 11 shtesë e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**